



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 04/107

Datë: 18.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept dokumenti për Persona të Zhdukur.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit/Ured Premijera /Office of the Prime Minister

Koncept Dokumenti për Persona
të Zhdukur

Maj 2019

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Përmbajtja

Përmbledhje e koncept dokumentit.....	3
Hyre.....	3
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit	8
Kapitulli 2: Objektivat.....	11
Kapitulli 3: Opsionet.....	23
Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim (status quo)	24
Kapitulli 3.2: Opsioni për plotësim ndryshim të ligjeve aktuale	24
Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë për mirësimin i zbatimit dhe ekzekutimit të legjislationit aktual.....	24
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme	25
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave.....	26
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi.....	27
Kapitulli 6: Krahësimi i opsioneve.....	28
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme.....	31
Kapitulli 6.2: Tabela e krahësimit me të tre opsionet	32
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm.....	36
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin	38
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik	38
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqëror	38
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore	41
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore.....	45
	48

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit të legjislacionit aktual

PËRMBLEDHJE E KONCEPT DOKUMENTIT

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept Dokument për Cështjen e Personave të Zhdukur
Ministria bartëse	Zyra e Kryeministrit - Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur
Personi kontaktues	Jabja Lluca , Këshilltar i Kryeministrit / Udhëheqës i Ekipit për Hartimin e Koncept Dokumentit për Persona të Zhdukur
PVPQ	Plani Vjetor i Punës së Qeverisë për vitin 2019, Zyra e Kryeministrit, Tabela B, objektivi 7 aktiviteti 7.2 treguesi 1 si dhe Lista e Koncept Dokumenteve për vitin 2019 e miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit ;
Prioriteti strategjik	Ndërlidhet me prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila përmes këtij Koncept Dokumenti planifikon avancimin e mekanizmeve për hulumtimin e fatit të personave të zhdukur, zgjidhjen e statusit të Personave të Zhdukur dhe Familjarëve të tyre, konservimin dhe ruajtjen e artefakteve dhe gjësendeve të Personave të zhdukur, mbështetjen e shogatave të familjarëve të personave të zhdukur.
	Programi i Qeverisë 2017-2021

Vendimi	
Cështja kryesore	RREGULLIMI I STATUSIT TË PERSONIT TË ZHDUKUR DHE E FAMILJARËVE TË TYRE
Përmbledhje e konsultimeve	Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur gjatë zbatimit të Ligji Nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur dhe legjislacionin tjetër që trajton cështjen e personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre ka hasur dispozita ligjore të cilat e kanë ndikuar drejtpërdrejtë në jetën e familjarëve të të zhdukurve, në veçanti në anën ekonomike-sociale. Familjarët e të zhdukurve janë ndier të diskriminuar dhe nëpërkëmbur në rastet kur është dashur të vendosin në mes të së drejtës për pension individual dhe atij familjar, si familjar i personit të zhdukur. Gjithashtu është

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

përfjetuar rëndë edhe shkalla e përqindjes për dy e më tepër familjarë të zhdukur, që shpeshherë e kanë përfjetuar si fyerje për viktimat dhe trajtim jo të barabartë të tyre.

Me legjislacionin aktual çështja e personave të zhdukur dhe e familjarëve të tyre trajtohet në së paku 4 Ligje, disa nga të cilat në vetvete përmbajnë edhe dispozita kundërshtuese ndaj njëra tjetres, të cilat vështirësojnë zbatimin e tyre në praktikë dhe vënë në pozita të pabarabarta familjet përfjetuese të kategorive të dala nga lufta.

Ligji Nr. 04/L-023 Për Persona Të Zhdukur, paraqet bazën e trajtimit të kësaj kategorie dhe deri diku plotëson nevojat e përgjithshme për hulumtimin e faktit të personit të zhdukur, rregullimin e statusit të personit të zhdukur dhe familjarëve të tyre, kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, si i vetmi autoritet institucional që bënë koordinimin e angazhimeve për zbardhjen e faktit të personave të zhdukur. Legjislacioni tjetër që ka të bëjë kryesisht me benificione/përfitimet e familjeve të personave të zhdukur i vë ata në pozitë të pabarabartë me kategoritë e tjera të dala nga lufta, të përshkuara në Ligjin Nr. 04/L-054 Për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve Invalideve Veteranëve Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Viktimave Civile dhe Familjet e Tyre, si dhe brenda kategorisë së familjeve të personave të zhdukur krijohen dy kategori të përkrahjes. Ligji në fjalë ka një dispozitë ligjore, sipas së cilës familjet e personave të zhdukur pas datës 20 qershor 1999 e humbin të drejtën e mbështetjes institucionale me rastin e zbardhjes së faktit të personit të zhdukur. Një dispozitë e tillë nga familjarët është vlerësuar diskriminuese, duke pasë në konsideratë se i njëjti trajtohet viktimë si pasojë e luftës.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale Të Financuara nga Shteti, familjarët e personave të zhdukur, si kategori e dalë nga lufta, janë detyruar që të përcaktohen se cilin pension do ta realizojnë-pensionin individual apo atë familjar. Kjo ka rezultuar me ndërprerje të herëpashershme të mbështetjes, e paraparë me Ligjin Nr.04/L-054, prandaj nevojitet saktësim sa u përket dispozitave ligjore, me të cilat do të lejohet gëzimi i së drejtës në pension individual, si e drejtë e paqetësueshme dhe, në anën tjetër realizimi i pensionit familjar, ashtu si e përcakton legjislacioni për kategoritë e dala nga lufta.

Përderisa Ligji Nr. 04/L-023 Për Persona të Zhdukur përcakton Komisionin Qeveritar , si mekanizëm ndër-institucional si autoritetin përgjegjës për hulumtimin dhe zbardhjen e faktit të personave të zhdukur, në anën tjetër

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

edhe Ligji Nr. 05/L-060 Për Mjekësinë Ligjore, i jep këtij institucioni po të njëjtat detyra dhe përgjegjësi, gjë që në praktikë shpeshherë është hasur në keqkuptim dhe keqinterpretim.

Gjatë takimeve me familjarë të personave të zhdukur, organizata të shoqërisë civile, Asociacion e Familjeve të Personave të Zhdukur, organizata ndërkombëtare si, Komiteti Ndërkombëtarë i Kryqit të Kuq, Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, Delegacionin e Kosovës për Bisedime për të Zhdukurit, ekspertë të fushës janë zhvilluar konsulta për identifikimin e problemeve dhe adresimin e tyre, me qëllim të ndryshimit dhe avancimit të politikave të efektshme, për trajtimin e kësaj kategorie.

Nga muaji tetor 2017 janë realizuar një mori konsultash nga të cilat kanë dalë sugjerime dhe rekomandime për përmbytjen e dokumentit, përmes së cilës do të trajtoheshin të gjitha nevojat dhe shqetësimet në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur, trajtimin dinjitoz të familjarëve të tyre si dhe trajtimin e artefakteve dhe lokacioneve ku janë gjetur apo varrosur personat e zhdukur.

Pas përfundimit të konsultave paraprahe është caktuar Grupi Punues për hartimin e Koncept Dokumentit, i cili gjatë 3 (tri) punëtorive/takimeve të mbajtura ka hartuar draft konceptin, me propozimet dhe sugjerimet e palëve për të përfshira. Grupi Punues parapraakisht ka realizuar takime me institucionet të cilat ndikohen nga këto politika, politika veprimet me qëllim të hartimit të politikave të zbatueshme në praktikë dhe harmonizimit të politikave shtetërore.

Draft koncept dokumenti u është shpërndarë grupeve të interesit të cilat kanë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre, të cilat janë trajtuar në punëtorinë e fundit, të mbajtur më 22 - 24 mars 2019.

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

	Grupi Punues gjatë hartimit të koncept dokumentit ka pasë për bazë interesin më të mirë të personit të zhdukur dhe familjarëve të tyre si dhe përgjegjësitë shtetërore në raport me këto kategori, e po ashtu edhe përvojat nga shtetet tjera, në veçanti shtetet në rajon. Aktivitetet kryesore të konsultimit publik: - 2 tetor 2017, Takimi i përbashkët konsultativ me përfaqësues të institucioneve dhe organizatave (shoqatave të familjeve) të angazhuara në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur (takimi i ftuar nga Kryeministri); - 7 shtator 2018, Takimi i parë i Ekipit përgjegjës për hartimin e Koncept Dokumentin për Persona të Zhdukur; - 14 - 16 nëntor 2018, Punëtoria rajonale për çështjet ligjore në raport me familjet e personave të zhdukur (Punëtoria e organizuar në Sarajevë, nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq); - 25 shkurt 2019, punëtoria / takimi i përbashkët konsultativ me përfaqësues të institucioneve dhe organizatave (shoqatave të familjeve) të angazhuara në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur - 22 - 24 mars 2019, punëtoria për finalizimin e 'Analizës / Koncept Dokumentit për Persona të Zhdukur'; - Si dhe një sërë takimesh me akterët e angazhuar në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur, në veçanti takimet me shoqatat e familjeve të personave të zhdukur.
Opsioni i propozuar	OPSIONI I REKOMANDUAR-OPSIONI 2: Grupi Punues ka vlerësuar Opsionin e Dytë si më të preferuar: • Plotësim ndryshim - Ligji Nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur; • Plotësim ndryshim/amandamentim i Ligjit Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Viktimave Civile dhe Familjarëve të Tyre; • Plotësim ndryshim/amandamentim ndryshim i Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti,

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Ky opsion i rekomanduar është elaboruar dhe arsyetuar në Kapitullin: **Opsionet.**

Ndikimet kryesore të prishme

Ndikimet buxhetore	Opsioni i propozuar në këtë Koncept Dokument do të ketë ndikim buxhetor.		
	Viti 1	Viti 2	Viti 3
	1,128,000.00	1,128,000.00	1,128,000.00
Ndikimet ekonomike	Opsioni i propozuar në këtë Koncept Dokument nuk ka ndikime në këtë kategori		
Ndikimet shoqërore	Opsioni i propozuar, në këtë Koncept Dokument ka ndikim nëpërmjet ofrimit të shërbimeve shëndetësore, sociale dhe familjare.		
Ndikimet mjedisore	Opsioni i propozuar në këtë Koncept Dokument nuk ka ndikime në këtë kategori		
Ndikimet ndër-sektoriale	Opsioni i propozuar në këtë Koncept Dokument nuk ka ndikime në këtë kategori		
Ngarakesat administrative për kompanitë	Opsioni i propozuar në këtë Koncept Dokument nuk ka ndikime në këtë kategori		
Testi i NVM-ve	Opsioni i propozuar në këtë Koncept Dokument nuk ka ndikime në këtë kategori		

Hapat e ardhshëm

Afatshtkurtër	Me rastin e aprovimit të Koncept Dokumentit me Opsionin e rekomanduar nga Grupi Punues, brenda vitit të parë do të hartohet dhe aprovohet Plotësim ndryshim - Ligji Nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur; Plotësim ndryshimi i Ligjit Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Viktimave Civile dhe Familjarëve të Tyre si dhe Plotësim ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.
---------------	--

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONATE ZHDUKUR

Alatmesëm	Pas aprovimit të Plotësim Ndryshimeve në Ligjet e sipërshënuara dhe miratimit të tyre në Kuvendin e Kosovës, KQZJH do të krijohet Grupi Punues për hartimin e akteve nënligjore, të cilat do të mundësonin zbatimin të plotë të ligjit.
-----------	---

HYRJE

Përkundër faktit se në përfundim të Luftës në Kosovë janë shënuar mbi 6 mijë persona të zhdukur, as Administrata Ndërkombëtare e më vonë as Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse nuk kanë hartuar kornizë ligjore, e cila do të përcaktonte statusin e personit të zhdukur e as të familjarëve të tyre.

Gëshija e personave të zhdukur përkatësisht hulumtimin dhe identifikimi i personave të zhdukur ka qenë kompetencë e ndërkombëtareve, fillimisht e trajtuar nga ish-Tribunali i Hagës (fokus i punës ishte më shumë trajtimi i rasteve në aspektin penal) për të vazhduar me themelimin dhe punën e Komisionit 'VRJC' (në përbërje kryesisht të organizatave / mekanizmave ndërkombëtar). Ndërsa në vitin 2002 në kuadër të Shtyllës së Drejtësisë së Misionit të OKB për Kosovë-UNMIK, ka ekzistuar një zyrë 'OMPF (Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore) e cila është marrë me hulumtimin dhe identifikimin e personave të zhdukur, kompetencë e cila më vonë është transformuar në Departamentin e Mjekësisë Ligjore (në të cilin ishin fuzionuar ish- OMPF në kuadër të Departamentit të Drejtësisë –UNMIK/Ministritë së Drejtësisë dhe ish-Instituti i Mjekësisë Ligjore në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë). Përkundër faktit se gëshija e krimeve të luftës, përfshirë edhe gëshijen e personave të zhdukur, ishte kompetentë e rezervuar për misionet ndërkombëtare, të cilat gëshijen në kuptimin e hulumtimit por edhe respektimit të të drejtave të familjeve e rregulluan me rregullat / dokumentet mbi bazën e të cilave vepronin, në të njëjtën kohë institucionet e Kosovës, krijuan mekanizma kompetent institucional në veçanti në përpjekje për një trajtim të mirë institucional të familjeve të personave të zhdukur. Fillimisht, në kuadër të Qeverisë, funksiononte Zyra/Komisioni për Persona të Zhdukur, e themeluar apo avancuar në vitin 2006 si Komision Qeveritar (ndër-institucional) për Persona të Pagjetur (Zhdukur), autoriteti i të cilit ka qenë koordinimi i veprimeve institucionale dhe bashkëpunimi me familjarë dhe organizata vendore e ndërkombëtare për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. Në vitin 2004, me qëllim të shkëmbimit të informatare dhe mbështetjen e mekanizmave për hulumtimin e fatit të të zhdukurve është krijuar Grupi Punues për Bisedime për Persona të Zhdukur, i kryesuar nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, me pjesëmarrje të Delegacionit të Kosovës dhe të Serbisë.

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Pas disa përpjekjeve (disa projektligjeve ndër-vite / kryesisht 2009 dhe 2010), në vitin 2011 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar LIGJIN NR. 04/L-023 PËR PERSONA TË ZHDUKUR, dhe ka përcaktuar detyrat, përgjegjësitë dhe obligimet e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur si dhe të drejtat dhe statusin e personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre.

Edhe përkundër miratimit të këtij Ligji, kompetencat kryesore në hulumtimin e fatit të personave të zhdukur dhe identifikimin e tyre, nga Administrata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë-UNMIK në vitin 2008 është bartur tek Misioni Evropian-EULEX, nga i cili është varë edhe angazhimi i aktërëve vendorë të përfshirë në hulumtimin dhe identifikimin e personave të zhdukur. Kjo gjendje ka vazhduar deri në gusht 2018, kur mandati e EULEX ka ndryshuar dhe kompetencat kanë kaluar tek institucionet vendore.

Megjithë ekzistimin e bazës ligjore për trajtim të personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre, shumica e familjarëve dhe shoqatave të tyre, kanë shprehë shqetësim se legjislacioni aktual nuk parashihet interesin më të mirë të personit të zhdukur dhe familjeve të tyre. Kjo gjendje ka ndikuar që familjarët të gjykojnë se janë të diskriminuar dhe se kanë mbetë në mëshirën e fatit.

Në të gjitha takimet formale dhe joformale me familjarë nga ana e tyre janë shprehë shqetësime dhe kërkesa për ndryshim të ligjit, përmes të cilave familjarët do të trajtoheshin dinjitetshëm dhe të barabartë me kategoritë e tjera të dala nga lufta. Gjithashtu kanë shfaqur edhe shqetësime të vazhdueshme për trajtim jo adekuat të artefakteve dhe rrobave të të zhdukurve si dhe drojën për zhdukjen e gjurmëve të krimeve.

Nga këto takime është shfaqur nevoja e avancimit të politikave institucionale, përmes të cilave do të kishte një qasje dhe trajtim meritior për personat e zhdukur dhe familjet e tyre.

Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokument për çështjen e Personave të Zhdukur
Ministria bartëse	ZKM/KQZHZH
Personi kontaktues	Jahija Lulka, Këshilltar i Kryeministrit / Kryetar i Ekipit për hartimin e Koncept Dokumentit
PVPQ	Plani Vjetor i Punës së Qeverisë për vitin 2019, Zyra e Kryeministrit, Tabela B, objektivi 7 aktiviteti 7.2 treguesi 1 si dhe Lista e Koncept Dokumenteve për vitin 2019 e miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i ZKM

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Prioriteti strategjik	Ndërlidhet me prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila përmes këtij Koncept Dokumenti planifikon avancimin e mekanizmave për hulumtimin e fatit të personave të zhdukur, zgjidhjen e statusit të personave të zhdukur dhe Familjarëve të tyre, konservimin dhe ruajtjen e artefakteve dhe gjësëndeve të personave të zhdukur, mbështetjen e shogatave të familjarëve të personave të zhdukur.
Grupi punues	Programi i Qeverisë 2017-2021 Ekipi për hartimin e Koncept Dokumentit - <i>Jahja Lluka, këshilltar i KM- kryetar;</i> - <i>Mentor Borovci, ZL/ZKKM-anëtar;</i> - <i>Arben Krasniqi, SKQ/ZKKM-anëtar;</i> - <i>Kushtrim Gara, KQPZH-anëtar;</i> - <i>Xhavri Bulliqi, ZL/ZKKM-anëtar;</i> - <i>Adnan Ahmeti, ZPS/ZKKM-anëtar;</i> - <i>Shaban Ademi, ZBF/ZKKM-anëtar;</i> - <i>Arlinda Likaj-Sejdiu, Koordinatorë për Integrim Evropian/ZKKM-anëtare;</i> - <i>Mirlinda Lushtaku, SKQ/ZKKM, anëtare;</i> - <i>Ismet Cakiqi, ZKP/ZKKM-anëtar;</i> - <i>Naser Ajeti, ABG/ZKKM-anëtar.</i> Në cilësinë e ekspertëve të fushës dhe përfaqësues të ministrisë së linjës: - <i>Prende Gjetai, kryesues i KQPZH;</i> - <i>Ibrahim Makolli, kryetar i Delegacionit për Bisedime me Serbinë për çështjen e personave të Zhdukur;</i> - <i>Nysrete Kunnova, anëtare e KQPZH dhe përfaqësuese e shogatave të familjeve në KQPZH;</i> - <i>Altin Ademi, këshilltar politik i Ministrisë të Drejtësisë;</i> - <i>Sheremet Ademi, Shogatat e familjeve të personave të Zhdukurve;</i> - <i>Almet Graqevci, anëtar i KQPZH dhe përfaqësuese e shogatave të familjeve në KQPZH;</i> - <i>Arife Gasli, ZKM-SKQ</i> Anëtarë të jashtëm: - <i>Velbi Selmani, UNDP</i>

	- <i>Arijea Kelmeniti, këshilltare e jashtme/UNDP, anëtare;</i> - <i>Dardan Berisha, këshilltar i jashtëm</i> - <i>Naim Ineri, KNKK</i>
Informata shpeshë	Arsyeja për plotësim ndryshim të legjislacionit që trajton çështjen e personave të zhdukur, përpos nevojës së brendshme vjen edhe si rezultat i përmbytjes së obligimeve dhe përgjegjësiive institucionale të Republikës së Kosovës nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe Planin Kornizë Rajonal, të arritura në vitin 2018.

KAPITULLI 1: PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Zbardhja e faktit të Personave të Zhdukur, statusi i Personave të Zhdukur dhe i familjarëve të tyre, konservimi dhe ruajtja e artefakteve e gjësendeve të tjera të gjetur me trupat e zhdukur, trajtimi i lokacioneve dhe varrezave ku janë gjetur personat e zhdukur, përkrahja e familjeve të Personave të Zhdukur dhe e Shoqatave të Familjarëve ka qenë dhe mbetet një nga sfidat më të mëdha për institucionet e vendit dhe shoqërinë në përgjithësi.

Infrastruktura ligjore, që rregullon këtë materie, e përmbledhur në Ligjin Nr.04/L-023 për Personat e Zhdukur dhe Ligji Nr.04/L-054, Mbi Statusin dhe të Drejtat e Martirëve, Invalidëve, Veteranëve, Anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre, nuk plotëson në tërësi nevojat dhe nuk trajton plotësisht shqetësimet e familjarëve të kësaj kategorie. Për më tepër disa dispozita ligjore kanë prodhuar trajtim jo të barabartë në mes kategorive të ndryshme të dala nga Lufta, gjë që ka rezultuar me shqetësim dhe pakënaqësi të familjarëve.

Pas prezantimit të dy dokumenteve analitike për gjendjen aktuale të bazës ligjore, kërkesat dhe çështjet e adresuara për plotësim/ndryshim, (dokumente të përgatitura nga konsulentët e angazhuar nga UNDP), në kuadër të diskutimeve gjatë punëtorisë janë trajtuar mangësitë e legjislacionit ekzistues dhe nevoja për adresim të kërkesave, nevojave dhe shqetësimeve të familjarëve dhe të institucioneve që trajtojnë çështjet e personave të zhdukur .

Grupi Punues për hartimin e Koncept Dokumentit kanë diskutuar dhe trajtuar çështjet me interes për Personat e Zhdukur dhe Familjarët e tyre, për të cilat është prezantuar gjendja aktuale, në kuptimin se si është përshkruar në Ligjin nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur dhe ligjet e tjera që trajtojnë çështjen e personave të zhdukur dhe më pas është hapur diskutimi për secilën veç e veç, duke prezantuar kërkesat e familjeve, si dhe duke analizuar bazën ligjore në fuqi, praktikën ndërkombëtare dhe mënyrën se si këto çështje janë rregulluar në legjislacionin e vendeve të tjera, të cilat përballen me çështjen e të zhdukurve. Grupi Punues ka pas për bazë edhe

instrumentet ndërkombëtare, në veçanti Konventën e Zhdokjeve me Dhunë, Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, etj. në të cilat garantohet e drejta e familjarëve për t'u informuar për gjendjen dhe vendndodhjen e familjarit të tij/ saj si dhe obligimet e palëve për të ofruar informacion për gjendjen dhe vendndodhjen e tyre.

Një nga çështjet e trajtuara ka të bëjë edhe me terminologjinë e përdorur në legjislacionin aktual, në veçanti termin i "ZHDUKUR", i normuar në Ligjin Nr. 04/L-023 Për Persona të Zhdokur dhe Ligjin Nr. 04/L-054 Për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmoreve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre. Në të dyja këto ligje përdoret termi 'zhdokur', ndërsa në Ligjin Nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore përdoret termi i 'PAGJETUR'.

Ligjet ekzistuese në përgjithësi rregullojnë statusin e personave të zhdokur dhe familjarëve të tyre, por gjatë zbatimit janë vërejtur fusha, të cilat kërkojnë të detajohen dhe përkufizohen saktë, sidomos termet dhe të drejtat sikurse për të zhdokurit, po ashtu edhe të familjarëve të tyre, në veçanti në përkrahjen shtetërore, e cila është e ndryshueshme nga kategoritë e tjera, të dala nga lufta.

- Diskriminuese është vlerësuar përcaktimi për pensionin që duhet ta gëzoj familjari/familjarët i/e të zhdokurit/zhdokurve si dhe përqindja në raport me numrin e të zhdokurve të një familje.
- Trajtimi jo i barabartë me kategoritë e tjera të përshkruara në Ligjin Nr. 04/L-054, në gëzinin e mbështetjes institucionale, në shërbetësi, në lehtësira të tjera në shërbimet publike.
- Hunbja e së drejtës për përkrahje institucionale të familjarëve të personave të zhdokur të pas datës 20 qershor 1999, pas zbatimit së faktit të tyre.
- Legjislacioni ekzistues pjesërisht trajton çështjen e artefakteve dhe rrobave të të zhdokurve si dhe trajtimin e lokacioneve/venduarrezaave ku janë gjetur trupat e të zhdokurve.

Sipas Ligjit nr. 04/L-023 për Persona të Zhdokur : 1.1. Person i zhdokur është personi vendndodhja e të cilit është e panjohur për familjarët dhe kërkuar të tij/saj dhe i cili në bazë të informacionit të besueshëm, është zhdokur në periudhën mes 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000, si pasojë e luftës në Kosovë në vitet 1998-1999. 1.2. Familjar i personi të zhdokur nënkupton pjesëtarin e familjes së një personi të zhdokur të përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Familjen i Kosovës nëse nuk specifikohet ndryshe, për qëllime të këtij ligji. Sipas Ligjit nr. 04/L-05 për statusin dhe të drejtat e Dëshmoreve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre : 1.13. Ushtar i zhdokur (i pagjetur) i UÇK-së – veterani dhe pjesëtar i UÇK-së, fati i të cilit ende nuk është zbardhur; 1.14. Person civil i zhdokur – personin vendndodhja e të cilit është e panjohur për familjarët e tij/ saj dhe i cili në bazë të informacionit të besueshëm,

është zhdukur në periudhën mes 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000, si pasojë e luftës në Kosovë në vitet 1998-1999; 1.15. Anëtarë të familjes së ngushtë në kuptim të këtij ligji janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar (birësuar), prindërit, njerka, njerku, thjeshtri, thjeshtra si dhe bashkëshorti/ bashkëshortja jashtëmartesore.

Megjë me këtë Ligj trajtohen vetëm rastet e personave të zhdukur gjatë Luftës së fundit, atëherë fokusi do të mbetet brenda periudhave të Luftës së viteve 1998 - 1999. Në respektim të së drejtës së familjeve për të ditur fatin dhe vendndodhjen e familjarëve të tyre të zhdukur, do të vazhdohet të përfshihet periudha e pasluftës.

KQPZH është përballur edhe me kërkesa të familjarëve për të hulumtuar për fatin e personave të zhdukur nga luftërat në ish-Jugosllavi, nga viti 1990. Për të realizuar këtë kërkesë të familjarëve Grupi Punues ka vlerësuar se është ë nevojshme që mandati i KQPZH të përfshijë edhe atë periudhë kohore, natyrisht në bashkëpunim me autoritetet e vendeve përkatëse. Kësisoj, Republika e Kosovës do t'u dilte në përgjigje të gjithë shtetasve të vet të cilët kanë familjarë të zhdukur në luftërat e ish-Jugosllavisë. Propozohet që të trajtohen, në kuptimin e evidentimit, gjëves dhe rivarrimit edhe rastet e personave të zhdukur si pasojë e luftërave në ish-Jugosllavi. Kjo nënkupton që në plotësim ndryshimet e Ligjit të shtohen paragrafë për rastet e personave të zhdukur gjatë luftërave në ish-Jugosllavi.

Komisioni ose subjektit pasardhës të cilit i jepet i njëjti mandat, bashkërendon aktivitetet me institucionet vendore, ndërkombëtare dhe akterët tjerë, në lidhje me ndërtimin e monumentit apo nismat tjera që kanë të bëjnë me nderimin e personave të zhdukur. Sfidat apo çështjet që janë trajtuar nga Grupi Punues në këtë temë janë: **gëshija e robave dhe artefakteve; dokumentimi i varrezave masive dhe shenjëzimi i lokacioneve të vendvarrezave të jashtëligjshme**; si dhe **dokumentacioni i mbledhur nga shogatat vendore, organizatat ndërkombëtare që ishin të angazhuara në këtë proces**. Është vlerësuar nevoja që çështjet e lartshënuara të adresohen në plotësim / ndryshim të Ligjit, qoftë me një nen të veçantë, ose si ri-formulim i nenit 11 (paragrafi 4) të Ligjit aktual për Persona të Zhdukur. Po ashtu në Ligj, të definohet edhe **27 Prilli - Ditë e Personave të Zhdukur të Kosovës**. Kjo datë shënohet në Kosovë sipas një Rezolute të Kuvendit të Kosovës, por që ka nevojë të përfshihet në ligj.

Procedurat e kërimit dhe ndërprerjes së kërimit janë rregulluar me Nenin 7, të Ligjit nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur Sfidat apo problemet: pagatësi te afatet kohore (mos definim i qartë) ; si dhe pagatësi nëse sipas Nenit 6, paragrafit 3, Gjykata duhet të ruajë vetëm interesin e personit të zhdukur, apo edhe të anëtarëve tjerë të familje. Grupi Punues ka vlerësuar se duhet të përfundojë hartimi dhe aprovimi i aktit nënligjor për mbylljen e rasteve (i paraparë në Ligjin nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur). Ndërsa afatet kohore të definohen edhe në Ligjin për persona të zhdukur, në veçanti në nenin 7 dhe nenin 5 për aq sa është e mundur, apo t'i referohet

afateve kohore dhe të jetë në harmoni me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Për çështjen e nenit 6, paragrafi 3, do të analizohet në tërësi neni 5 dhe neni 6 i Ligjit nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur.

Sipas ligjit aktual, **familjar i personit të zhdukur** nënkupton pjesëtarin e familjes së një personi të zhdukur të përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Familjen i Kosovës nëse nuk specifikohet ndryshe, për qëllime të këtij ligji. 1.1. **Person i zhdukur** është personi vendndodhja e të cilit është e panjohur për familjarët dhe kërkuesit e tij/saj dhe i cili në bazë të informacionit të besueshëm, është zhdukur në periudhën mes 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000, si pasojë e luftës në Kosovë në vitet 1998-1999. Sipas Ligjit nr. 04/L-05 për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre : 1.13. **Ushtar i zhdukur (i pagjetur)** i UÇK-së – veteran dhe pjesëtari i UÇK-së, fati i të cilit ende nuk është zbardhur;

Person civil i zhdukur – personin vendndodhja e të cilit është e panjohur për familjarët e tij/saj dhe i cili në bazë të informacionit të besueshëm, është zhdukur në periudhën mes 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000, si pasojë e luftës në Kosovë në vitet 1998-1999; 1.15. **Anëtarë të familjes së ngushtë** në kuptim të këtij ligji janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar (birësuar), prindërit, njerka, njerku, thjeshtri, thjeshtra si dhe bashkëshorti/ bashkëshortja jashtëmartesor. **Të drejtat e familjeve** që janë rregulluar me Ligjin për Persona të Zhdukur, janë, ndër të tjera: E drejta e familjarëve për t'u informuar për fatin e personave të zhdukur (Neni 5), Të drejtat e familjarëve në lidhje me statusin juridik të personave të zhdukur (neni 6). **Ndërsa e drejta në pension dhe benificionet** tjera janë rregulluar me Ligjin nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, (Neni 8 E drejta në pension dhe benificione për familjet e dëshmorëve dhe të zhdururve të UÇK-së dhe Neni 13 të drejtat e anëtarëve të familjes së viktimës civile të luftës).

Sipas dispozitave të mësipërme vërehet standard i dyfishtë brenda të njëjtës kategori; mospërputhja e datave mes të zhdukurit civil dhe viktimës civile që ndikon në realizimin e të drejtave të familjeve, pas identifikimit; mospërputhje e benificioneve të garantuara mes familjes së personit të zhdukur ushtar i UÇK-së dhe familjes së personit të zhdukur civil; ndërpreja e pensionit (sipas Ligjit për Skemat Pensionale); përqindja e aplikuar sipas Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre (për dy e më shumë të zhdukur), përqindje kjo e papranuar për familjet e personave të zhdukur, në mënyrën se si është rregulluar/pëshkruar; ndalimi i dy më shumë pensioneve (sipas Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti); si dhe pagartësi në 'të drejtën e familjeve për pjesëmarrje në kërkim'. Grupi Punues propozon ndryshimin e Neni 16 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Nëse, për çfarëdo arsye nuk ka ndryshim plotësim të nenit të cituar më lartë, atëherë në Ligjin nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre termi "pension" të

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

zëvendësohet me një term tjetër të përshtatshëm, psh "përkrahje shtetërore", e cila do të mundësojë realizim të së drejtës në pension individual dhe përkrahjes shtetërore për familjarët, që në legjislationin aktual përkufizohet "PENSION FAMILJAR".

Grupi Punues ka vlerësuar që gjitha të benificionet, përveç **lartësisë së pensionit**, sipas Nenet 8 të Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, të rregullohen edhe për familjet e personave të zhdukur civil (benificionet përfshijnë, ndër të tjera: Përparësi në punësim; Përparësi në regjistrim dhe në pranim në institucionet publike; Bursa në arsimin e mesëm dhe universitar; Akomodimi në konvikte pa kompensim shëndetësor i lirë; Akomodimi në konvikte për personat e moshuar; Lirimi nga pagesat e administratës në universitetet publike; Lirimi i pagesave në trafikun publik;) Për disa nga të drejtat e lartshënuara, procedurat, etj, specifikohen me aktet nënligjore. Po ashtu, familjet e personave të zhdukur duhet të pajisen me 'dokument zyrtar' e cila do t'i shërbenë për realizimin e të drejtave të garantuara me Ligj. Të garantohen këto të drejta për familjet e personave të zhdukur, edhe kur iu janë kthyer për rivarrim mbetjet mortore (modeli i Ligjit të Bosnjës).

Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
Ligji Nr.04/L-023 për Personat e Zhdukur	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2765	ZKM/KQPZH	1. Udhëheq, mbikëqyrë, bashkërendon dhe koordinon aktivitetet me institucionet vendore, bashkëpunon me Institucionet dhe Organizatat ndërkombëtare dhe akterët tjerë, në lidhje me zbardhjen e fatit të personave të zhdukur si rezultat i Luftës të viteve 1998-1999;

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

			2. Mbron të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre; 3. Krijon Regjistrin Qendror të Personave të Zhdukur; 4. Bashkërendon aktivitetet në mbledhjen e të dhënave në lidhje me personat e zhdukur; 5. Informon familjarët e personave të zhdukur dhe bashkëpunon me shoqatat e tyre duke i njoftuar familjarët për fatin e personave të zhdukur.
Ligji Nr.05/L-060, Për Mjekësinë Ligjore	https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/DEC70824-FB4D-4317-8895-89D5F2B1787C.pdf	MD/IML	1. Kërkimi, gjeja dhe zhvarimi, si dhe përcaktimi i fatit, identifikimi dhe dorëzimi i mbetjeve mortore të personave të pagjetur që ndërliqhen me luftën në Kosovë; 2. Certifikata e Vdekjes - dokument mjeko ligjor, që përmban përveç tjerash kohën, vendin, dhe shkakun e vdekjes, për rastet të cilat i nënshtrohen autopsisë mjeko ligjore; 3. Mbajtjen e regjistrave AMD dhe PMD të të gjitha rasteve të të pagjeturve/zhdokurve;

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

- Ligji Nr.04/L-054, Mbi Statusin dhe të Drejtat e Martirëve, Invalidëve, Veteranëve, Anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre - Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2793 https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9517	MPMS	- Pensionet e përcaktuara me Nenin 5.1.1.4; - Të drejtat e anëtarëve të familjes së viktimës civile të luftës/Të Drejtat dhe Benificionet (Neni 13); - Skemat pensionale të financuara nga shteti.
Rezoluta e Kuvendit të Kosovës për Personat e Zhdukur	http://kuvendikosoves.org/common/docs/2018_05_07_Rezolute_Nr_06_R_003.pdf		

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

- Rregullore Nr. 15/2012 për Punën e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8378	1. Hartimin dhe implementimin e planeve dhe strategjive të Komisionit, në kuadër të aktiviteteve në përputhje me mandatin e Komisionit; 2. Kontrollon procesin e shqyrtimit të kërkesave që KQPH-së, ua dërgon autoriteteve apo individëve relevantë, duke e informuar hierarkinë e tij apo të saj për parregullsitë eventuale dhe duke propozuar zgjidhje të duhura në këtë drejtim; 3. Instalon, administrojnë dhe mirëmban regjistrat të dhënave në bazën e të dhënave të KQPH-së; 4. Menaxhon dosjet; 5. Siguron azhurnimin dhe ruajtjen adekuate të informatave në dispozicion brenda KQPP-së (arkivimi, baza e të dhënave, regjistri); 6. Kërkesa për fillimin e procedurës për kërkimin e Personit të Zhdukur.
---	--	--

Sado që legjislacioni ekzistues përfshin çështjen e Personave të Zhdukur, megjithatë mungesa e harmonizimit të ligjeve të cilat prekin këtë fushë ka ndikuar në trajtimin jo adekuat të kësaj materije. Gjendja e përgjithshme ekonomike-sociale në Kosovë ka qenë faktor ndikues gjatë hartimit të legjislacionit aktual, që disa prej kategorive të përfshihen nga të drejtat që u takojnë kategorive të tjera, të parapara me liget në fuqi. Harmonizimi i legjislacionit do të ndikonte në eliminimin e pabarazisë dhe trajtimin dinjitoz për të gjitha kategoritë, e në këtë rast edhe për familjarët e personave të zhdukur.

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Legjislacioni aktual ka:

- detyruar familjarët të vendosin mes pensionit individual/kontributues dhe pensionit familjar për kategoritë e dala nga lufta;
- ndarë me përqindje lartësinë e shumës së pensionit familjar kur një familje ka 2 (dy) e më tepër të zhdukur;
- privuar nga gëzimi i beneficioneve rastet e mbyllura të të zhdukurve pas 20 qershor 1999;
- vënë në pozitë të barabartë në gëzimin e beneficioneve mes kategorive të dala nga lufta;
- ka trajtuar pjesërisht artefaktet dhe trobat/gjësundet e gjetura bashkë me trupat e të zhdukurve;
- ka trajtuar sipërfaqësisht shenjëziminin/rregullimin e lokacioneve ku janë gjetur trupat e të zhdukurve;

Mungesa e akteve nënligjore ka pamundësuar zbatimin në praktikë të disa prej dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 04/L-023 dhe si rrjedhojë nuk është arritur përmbushja e obligimeve të parapara me këtë ligj. Për më tepër, mungesa e këtyre akteve ka shkaktuar probleme serioze për familjarët e personave të zhdukur, të cilat në disa raste nuk kanë arritur të realizojnë të drejtat e parapara me ligjet në fuqi. Ky mosrealizim ka ndikuar në gjendjen ekonomike-sociale të familjarëve me çka është cenuar e drejta dhe interesi i tyre.

Figura 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	TË DREJTAT, INTERESAT DHE DINJITETI I FAMILJARËVE TË PERSONAVE TË ZHDUKUR	
	GJENDJA EKONOMIKE-SOCIALE DHE PSIKO SOCIALE	
Problemi kryesor	STATUSI I PERSONAVE TË ZHDUKUR DHE I FAMILJARËVE TË TYRE DHE PRIVIMI NGA GËZIMI I BENEFICIONEVE	
Shkaqet	MANGESITË LIGJORE-ZBATIMI NË PRAKTIKË I LEGJISLACIONIT PËR PERSONA TË ZHDUKUR DHE LEGJISLACIONIT NDËRLIDHËS	

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

	MOS-HARMONIZIMI I LIGJEVE QË TRAJTOJNË CËSHTJEN E PERSONAVE TË ZHDUKUR
	MUNGESA E AKTEVE NËNLIGJORE
	TRAJTIMI I PAMJAFTUESHËM LIGJOR I KRIJIMIT TË MEMORIES KOLEKTIVE
Problemi kryesor	
Shkaqet	MANGESITË LIGJORE-ZBATIMI NË PRAKTIKË I LEGJISLACIONIT PËR PERSONA TË ZHDUKUR DHE LEGJISLACIONIT NDËRLIDHËS MOS-HARMONIZIMI I LIGJEVE QË TRAJTOJNË CËSHTJEN E PERSONAVE TË ZHDUKUR

Sikur është thënë më lartë, në Ligjin Nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur dhe në Ligjin nr. 04/L-054 Për Statusin dhe të Drejtat E Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve Të Ushtrisë Çlirimtare Të Kosovës, Viktimave Civile Dhe Familjeve të Tyre, përdoret termi 'zhdukur', ndërsa në Ligjin nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore përdoret termi 'pagjetur'. Përdorimi i termave të ndryshëm (kryesisht 'zhdukur' dhe 'pagjetur') shpeshherë ka shkakuar konfuzion dhe zbrazëtrë në interpretim, pavarësisht se bëhet fjalë për të njëjtën kategori. Grupi Punues ka vlerësuar se në gjithë legjislacionin e Republikës së Kosovës duhet të përdoret një term unik sa i përket kësaj kategorie.

Ka dy mendime që mbizotërojnë në këtë drejtim:

-për përdorin të termnit:

1. "ZHDUKUR", duke u mbështetë edhe në dokumentet ndërkombëtare, dhe
2. "PAGJETUR", që është i përgatuar nga një numër i OJQ-ve dhe i familjarëve, duke pasë parasysh se flasim për një kategori, e cila është zhdukur dhunshëm, si rezultat i konfliktit të armatosur apo si pasojë e këtij konflikti (zhdurjet e pas qershor 1999).

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Pavarësisht kësaj, ekziston pajtuesmëri e plotë që të përdoret një term i vetëm, për të eliminuar të gjitha keqkuptimet dhe keqinterpretimet.

Grupi Punues, gjithashtu ka trajtuar edhe çështjet që kanë të bëjnë me periudhën kohore, e cila, sipas legjislacionit në fuqi, është e përkufizuar nga data 1 janar 1998 deri më 31 dhjetor 2000. Në këtë drejtim Grupi Punues ka vlerësuar se duhet të bëhet një dallim i qartë në mes të të zhdukurve gjatë kohës së luftës së armatosur dhe atyre që janë të zhdukur pas përfundimit të luftës, pra pas 20 qershor 1999. Disa nga pjesëmarrësit në konsulta kanë gjykuar se zhdukja e dhunshme në kohë lufte është bërë institucionalisht dhe për qëllime gjenocidale, ndërsa që të zhdukurit pas lufte janë si rezultat i veprimeve, kryesisht hakmarrëse, për shkak të pasojave që ka shkaktuar konflikti, apo për përfitime të tjera. Pavarësisht kësaj ndarjeje të qartë, që do të duhej të ekzistonte, obligimet dhe përgjegjësitë institucionale në raport me familjet e të zhdukurve duhet të jenë të njëjta

Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkaku-qet dhe/ ose efekti (efektet) me të cilat është e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkage) apo efektin (efektet)
ZKM/KOPZH	- Mundësia e vendimmarrjes, koordinimit dhe e zbatimit të legjislacionit në fuqi; - Përpilimi dhe aprovimi i akteve nënligjore; - Mbrojtja e të drejtave dhe interesit të Personave të Zhdukur dhe familjarëve; - Hartimi dhe mirëmbajtja e Regjistrit Qendror të personave të Zhdukur; - Pajisja me dokumentacion adekuat për familjarët e Personave të Zhdukur; - Mbledhjen, përpunimin e të dhënave të personave të Zhdukur dhe familjarëve të tyre; - Bashkëpunimin me shoqatat e familjarëve të personave të Zhdukur;	- Mbatja e takimeve të rregullta të KOPZH; - Krijimi dhe mirëmbajtja e Regjistrit Qendror për PZH; - Vlerësimi i kërkesave dhe ankesave; - Hartimi i dokumentacionit të nevojshëm për familjarët; - Krijimi i kushteve për bashkëpunim me shoqatat dhe asociacion e Familjarëve të PZH; - Mbledhja dhe përpunimi i informatave për fatin dhe vendndodhjen e PZH.

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

	- Shqyrtimin me kohë të kërkesave dhe ankesave të familjarëve të PZH;	
MPMS	- Rregullimi i pensioneve dhe beneficioneve për përfutuesit e të drejtës që burojnë nga Ligjet e sipërpërmendura; - Hartojnë dhe mirëmbajnë Listën e përfutuesve nga Skema Sociale, të familjarëve të personave të zhdukur.	- MPMS është përgjegjëse dhe autoritet qendror për hartimin e politikave sociale dhe pensionale; - Bartëse e Ligjit Nr. 04/L-054 - Bartëse e Ligjit Nr. 04/L-131
MD	- Nxjerja e akteve nënligjore, që bien në fushën e Ministrisë së Drejtësisë, e që rrjedhin nga Ligjet që trajtojnë çështjen e personave të zhdukur.	- Ministria e Drejtësisë është autoritet Qendror për hartimin dhe aprovimin e akteve nënligjore që ndërliqhen me çështjen e personave të zhdukur. - Ministria e Drejtësisë ka nën varësi Institutin e Mjekësisë Ligjore
Ministria e Shëndetësisë	- Ofrimi edhe i shërbimeve terciare për familjarët e PZH.	- Ministria e Shëndetësisë është autoritet që ofron shërbime mjekësore. Me ligjin në fuqi familjarët e personave të Zhdukur gëzojnë të drejtën e përkujdesjes shëndetësore primare dhe sekondare, pa kompensim në institucionet shëndetësore publike, ndërsa që kërkohet ofrimi edhe i shërbimeve shëndetësore në nivelin terciar.
Shoqatat e Familjarëve të Personave të Zhdukur dhe Asociacioni i Familjarëve të	- Pjesëmarrja direkte e familjarëve në hulumtimin dhe zbardhjen e fatit të PZH; - Përfitimet për organizatat e familjarëve të PZH. - Pjesëmarrja e Familjarëve në vendimarrje.	- Shoqatat e Familjarëve të PZH janë të përfaqësuar me 3 anëtarë në Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur, autoritet i cili merret me zbatimin e Ligjit për Persona të Zhdukur, gjeëgjësisht përgjegjëse për të drejtat dhe interesat e tyre;

Personave të Zhdukur		- Organizatat e Familjarëve të të Zhdukurve përfitojnë mbështetje nga shteti për realizimin e aktiviteteve të tyre. Në të ardhmen kërkohet mbështetje e vazhdueshme për aktivitetet e shogatave që mbrojnë të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre.
----------------------	--	---

KAPITULLI 2: OBJEKTIVAT

Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë

Qëllimi i politikës	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
- Trajtimi i barabartë i familjarëve të kategorive të dala nga lufta	Këto objektiva janë përshtatur për këtë koncept dokument
- Mbrojtja e të drejtave dhe interesit të personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre;	Këto objektiva janë përshtatur për këtë koncept dokument
- Institucionalizimi i memorjes kolektive për pasojat e luftës [çështja e rrobave dhe artefakteve ; memoriali ; dokumentimi i varrezave masive dhe shenjëzimi i lokacioneve të vendvarrezave të jashtëligjshme ; si dhe dokumentacioni i mbledhur nga shogatat, ojq, organizatat ndërkombëtare që ishin të angazhuara në këtë proces	
- Krijimi dhe mirëmbajtja e Regjistrit Qendror të Personave të Zhdukur	Këto objektiva janë të parapara me Ligjin në fuqi

KAPITULLI 3: OPSIONET

Gjatë konsultave dhe punëtorive të mbajtura me grupe të interesit dhe analizave të legjislacionit në fuqi, Grupi Punues për hartimin e këtij Koncept Dokumenti pasi ka trajtuar që të 3-a opsionet, duke e vlerësuar secilin prej tyre.

Opsioni i Parë, që ligji te mos ndryshohet dhe të vazhdohet gjendja e njëjtë duke thelluar vështirësitë në zbatim të ligjit por edhe në trajtim jo të barabartë të familjarëve të Personave të Zhdukur;

Opsioni i Dytë, amandamentimi i Legjislacionit, që trajtonë cështjen e Personave të Zhdukur, me të cilin do të eliminoheshin paqartësitë e identifikuara gjatë zbatimit të ligjeve në fuqi;

Opsioni i Tretë, Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit të legjislacionit aktual

Kapitulli 3.1:Opsioni i Parë: Opsioni asnjë ndryshim (status quo)

Opsioni i parë është që ligji te mos ndryshohet dhe të vazhdohet gjendja e njëjtë duke thelluar vështirësitë në zbatim të ligjit por edhe në trajtim jo te barabartë të familjarëve të Personave të Zhdukur. Ky opsion do të pamundësonte realizimin e plotë të të drejtave të familjarëve të PZH, sikurse edhe do të thellonte pabarazinë mes kategorive të dala nga lufta. Poashtu gjendja e njëjtë me legjislacionin do të pamundësonte trajtim meritur tyre lokacioneve dhe artefakteve të gjendura me personat e gjetur e të identifikuar, përfshirë dokumentacionin dhe memorien kolektive.

Kapitulli 3.2: Opsioni i Dytë: Plotësim ndryshimi i Ligjeve aktuale, që trajtojnë cështjet e personave të zhdukur

- Plotësim ndryshim të Ligjit nr. 04/1-023 për Persona të Zhdukur;
- Plotësim ndryshimi i dispozitave ligjore - Ligji nr.04/1-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Viktimave Civile
- Plotësim ndryshimi i dispozitave ligjore - Ligji nr. 04/1-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti

Ky opsion është trajtuar nga Grupi Punues dhe është vlerësuar si mundësi e mirë për të ndryshuar dhe plotësuar legjislacionin në fuqi, sipas të cilit do të trajtohej në mënyrë meritore e gjithë materia, duke pasur parasysh interesin më të mirë të PZH dhe familjarit të tij. Përmes ndryshim plotësimeve do të arrihej që të eliminoheshin paqartësitë në legjislacion, do të mundësohej koordinim dhe bashkëpunim institucional më i efektshëm, realizim i interesave dhe i të drejtave të familjarëve të PZH; do të mundësohej mbështetje institucionale për organizatat e familjarëve të PZH, sikurse edhe do të rezultonte me trajtim të barabartë të të gjitha kategorive të dala nga lufta.

Me plotësim ndryshime në skemën pensionale do të mundësohej që përfutesit e mbështetjes shtetërore të mos detyrohen të zgjedhin në mes të pensionit individual dhe pensionit familjar, të paraparë me Ligjin 04/L-054.

Pabarazia në trajtim , (dy-standardet brenda të njëjtës kategori), mospërputhja e datave mes të zhdokurit civil dhe viktimës civile që ndikon në realizimin e të drejtave të familjeve , pas identifikimit; mospërputhje e beneficioneve të garantuara mes familjes së personit të zhdokur ushtar i UÇK-së dhe familjes së personit të zhdokur civil; ndërprerja e pensionit (sipas Ligjit për Skemat Pensionale); përqindja e aplikuar sipas Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre (për dy e më shumë të zhdokur), përqindje kjo e papranuar për familjet e personave të zhdokur, në mënyrën se si është rregulluar/ përkshruar; ndalimi i dy më shumë pensione (sipas Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti); si dhe paqartësi në 'të drejtën e familjeve për pjesëmarrje në kërkim'.

Me ndryshim plotësim të këtyre ligjeve do të rregullohej dhe avancohej statusi i personave të zhdokur dhe familjarëve të tyre si dhe do të fuqizohet përkujdesja institucionale për memorien kolektive .

Grupi punues gjithashtu ka vlerësuar mundësinë për hartimin e një ligji të ri për PZH, i cili do të përshinte pjesë nga legjislacioni aktual, në vecanti Ligjit 04/L-054 dhe Ligjit 04/L-131, por ka vlerësuar se çështja mund të rregullohet edhe duke bërë plotësim ndryshim të ligjeve aktuale, duke pasqyruar realizimin e plotë të të drejtave dhe interesave të PZH dhe familjarëve të tyre. Grupi Punues ka pa në konsideratë edhe kohën e nevojshme për hartimin e një ligji të ri dhe zbrazëitren e cila do të ekzistonte deri në nxjerrjen e një akti të ri.

Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë: Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit të legjislacionit aktual

Grupi Punues ka shqyrtuar edhe mundësinë e përmirësimit të zbatimit dhe ekzekutimit të legjislacionit aktual, përmes aktivitete të caktuara por ka vlerësuar se objektivat e kësaj politike nuk mund të arrihen përmes këtij opsioni.

KAPITULLI 4: IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË ARDHSHME

Tabela më poshtë paraqet ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar. Shtojcat 1 deri 4 paraqesin vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve të të drejtave themelore. Këto mjete janë të listuara në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Katër shtojcat gjithashtu tregojnë vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës.

Figure 6: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuarra për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuarra
Ndikimet ekonomike	Pensionet dhe përfitimet do të ndikojnë në jetën e familjarëve të PZH, që njëherit janë kategoritë më të cënueshme në Kosove.
Ndikimet shoqërore	Do të rritet përkatësia për familjarët e PZH, e cila do të rezultonte me trajtim të dinjitetshëm në shoqëri, në vecanti se ndryshimet do të përfshinin edhe përkujdesjen për memorien kolektive.
Ndikimet mjedisore	Nuk ka
Ndikimet në të drejtat themelore	Përmes ndryshim-plotësimeve do të mundësohet realizim i të drejtave themelore të familjarëve të PZH.
Ndikimi gjinor	Trajtimi institucional do të ndikonte në vecanti tek gratë vetëmbajtëse, të cialt janë bartëse të vetme të ekonomive familjare.
Ndikimet e barazisë sociale	Elemnrimi i kriterëve të dyfishta të përfituesve të skenave pensionale do të ndikonte që familjarët e personave të zhdukur të gëzojnë të drejtën e realizimit individual krahas atij të paraparë me Ligjin 04-L/054
Ndikimet tek të rinjtë	Familjarët e personave të zhdukur përfshinë të gjitha moshat, në vecanti të rinjtë, andaj avancimet e të drejtave në ligj do të avancojnë edhe të drejtat e tyre, me cka do të ndikohet direkt tek të rinjtë, në vecanti në edukim dhe shëndetësi.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Pjesërisht: gjatë realizimit të të drejtave të garantuara me ligj (kartelata identifikuese, shërbimet shëndetësore, shërbimet komunale; shërbimet në arsimim).

	Si dhe në ristrukturimin institucional të mekanizmave kompetent të angazhuar në çështjen e personave të zhdukur.
Ndikimi i NMV-ve	Nuk ka

Grupi Punues për hartimin e konceptit dokumentit është shërbyer me informata dhe të dhëna nga aktetë të ndryshëm, qofshin ata përfutues apo aktetë të tjerë. Të dhënat, kryesisht kanë dalë nga takimet/ diskutimet e përbashkëta me familjarë të personave të zhdukur dhe organizata që merren më mbrojtjen e të drejtave të tyre, konkretisht Këshilli Koordinues i familjeve të Personave të Zhdukur.

Grupi Punues ka sistemuar të dhënat, në mbështetje të të cilave pastaj edhe janë hartuar ndikimet.

Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Grupi Punues gjatë hartimit të konceptit dokumentit është përballur më mungesë të të dhënave të sakta për numrin e përfutuesve si dhe numrin e anëtarëve të familjeve të prekura direkt, duke pasqyruar edhe faktin se një numër i familjarëve të të zhdukurve jetojnë jashtë Republikës së Kosovës. Megjithatë, gjatë punës janë shfrytëzuar të dhëna të Shogratave të Familjarëve të Personave të Zhdukur, të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq-KNKK, Komitetit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur-ICMP, UNDP, Agjencionit të Statistikave të Kosovës, Organizatave për të drejtat e njeriut, etj.

Disa nga sfidat që GP ka hasur gjatë punës janë:

- *Mungesa e të dhënave empirike për numrin e saktë të atyre tek të cilët ka ndikim direkt dhe indirekt mungesa e zbardhjes së faktit të të zhdukurve;*
- *Mungesa e të dhënave për përfutuesit direkt të mbështetjes shtetërore/pensionet në cilësinë e familjarit të PZH, rrjedhënisht mungon numri i anëtarëve të atyre familjeve, pra përfutuesve direkt dhe indirekt;*
- *Mungesa e të dhënave për realizimin e benificioneve në pajtim me ligjin në mbrojtjen shëndetësore, arsimit etj.*
- *Të zhdukurit e luftërave në ish-Jugosllavi (Slloveni, Kroaci, Bosnje) të viteve 1998 – 1999*
- *Statusi i personit të zhdukur, përkatësisht familjes së personit të zhdukur, pas identifikimit të mbetjeve mortore të personit të zhdukur.*
- *Statusi i familjes së personit të zhdukur të identifikuar, i zhdukur pas 20 qershor 2019.*

KAPITULLI 5: KOMUNIKIMI DHE KONSULTIMI

Diskutimet për nevojën e ndryshimit të politikave kanë filluar më herët, duke marrë parasyshë kërkesat e familjarëve të të zhdurve, të cilët i janë drejtuar KQPH me kërkesa në takime të KQPH apo edhe në takime të tjera konsultative dhe informative. Nga viti 2017 është intensifikuar puna në drejtim të hartimit të politikave të reja, të cilave u ka paraprirë konsultë e vazhdueshme me grupet e interesit dhe organizata vendore e ndërkombëtare, që trajtojnë çështjen e Personave të Zhdurkur.

Pas prezantimit të 'dy dokumenteve analitike' mbi gjendjen aktuale të bazës ligjore, kërkesat dhe çështjet e adresuara për plotësim/ndryshim, (dokumenteve të përgatitura nga konsulentët e angazhuar nga UNDP), në kuadër të diskutimeve gjatë punëtorisë janë diskutuar të gjitha çështjet e lartshënuara, fillimisht është prezantuar gjendja aktuale, në kuptimin se si është përshkruar në Ligjin nr. 04/L-023 për Persona të Zhdurkur dhe ligjet tjera që trajtojnë çështjen e personave të zhdurkur. Pastaj është hapur diskutimi për secilën çështje, duke prezantuar kërkesat e familjeve, si dhe duke analizuar bazën ligjore në fuqi, dhe mënyrën se si këto çështje janë rregulluar në Ligjin e Bosnjë Hercegovinës, në Projekt-Ligjin e Republikës së Kroacisë, dhe në Ligjin Model të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.

Në pajtim me rregullat për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, ky proces është bërë përmes metodave të ndryshme të informimit.

Punëtorja e organizuar me përkrahjen e Ambasadës Britanike përmes Projektit që është duke u implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), është mbajtur më 22 - 24 mars 2019, në Prevallë.

Çështjet e trajtuara:

- *Terminologjia, përkatësisht termi 'zhdurkur' i "pagjetur";*
- *Përkufizimi dhe statusi i personit të zhdurkur;*
- *Memoria kolektive;*
- *Kërkimi, gjetja dhe identifikimi;*
- *Të drejtat e familjeve të personave të zhdurkur;*
- *Struktura institucionale dhe përkrahja e shoqatave.*

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Figura 7. Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument

Procesi i konsultimit synon: Përfshirje të të gjithë akterëve dhe grupeve të interesit në hartimin e koncept dokumentit						
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi / njoftimi	Afati indikativ	Buxheti i nevojshëm	Personi përgjegjës
TAKIM PËRGATITOR	Grupi Punues/Ekipi përgjegjës për hartimin e Koncept Dokumentin për Persona të Zhdukur	Takimi i parë i Ekipit përgjegjës për hartimin e Koncept Dokumentin për Persona të Zhdukur;	Përmes e-mail	7 shtator 2018	Kosto administrative	Jahja Lluka; Kushtrim Gara.
TAKIM KONSULTATIV	OJQ e familjeve të personave të zhdukur; Organizata ndërkombëtare;	Takimi i përbashkët konsultativ me përfaqësues të institucioneve dhe organizatave (shoqatave të familjeve) të angazhuara në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur (takimi i ftuar nga Kryeministri) ;	Përmes e-mail	2 tetor 2018	Kosto administrative	Jahja Lluka; Kushtrim Gara.
TAKIM RAJONAL	Familjet e personave të zhdukur si pasojë e luftërave në ish-Jugosllavi dhe këmbimi i përvojave mes	Punëtorja rajonale për çështjet ligjore në raport me familjet e personave të zhdukur (Punëtorja e organizuar në Sarajevë, nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq);	Ftesa zyrtare	14 - 16 nëntor 2018	Kosto administrative për institucionet, ndërsa shpenzimet janë mbuluar nga organizatori	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

	institucionave të shteteve të rajonit				(rreth 2,000.00Euro)	
TAKIMI ME KRYEMINISTRIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS	Përfaqësuesit e familjeve të personave të zhdukur, të gjitha përkatësitë etnike	Punëtorja / takimi i përbashkët konsullativ me përfaqësues të institucioneve dhe organizatave (shoqatave të familjeve) të angazhuara në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur	Përmes emailit	25 shkurt 2019	Kosto administrative	Kabineti i Kryemini strit
PUNËTORIA E ORGANIZUAR	Anëtarët e Ekipit për gjegjë për hartimin e Koncept dokumentit	punëtorja për finalizimin e 'Analizës/Koncept Dokumentit për Persona të Zhdukur';	Përmes emailit	22 - 24 mars 2019	3,000.00 (trenijë) Euro	Organizuar nga UNDP
		Si dhe një sërë takimesh me akterët e angazhuar në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur, në veçanti takimet me shoqatat e familjeve të personave të zhdukur				
RESPEKTIMI I LEGJISLACIONIT DHE MUNDËSIA PËR DISKUTIM PUBLIK	Grupet e interesit, në veçanti familjet e personave të zhdukur dhe aktivistët e	Vendosja e Draft-Koncept Dokumentit në Platformën për Konsultimet Publike	http://konsultimet.rks.gov.net/vicëConsult.php?ConsultationID=40640	25 prill - 15 maj 2019		Kushtrim Gara

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

angazhuar në procesin e ndritimit të fatit të personave të zhdukur						

KAPITULLI 6: KRAHASIMI I OPSIONEVE

Grupi Punues për hartimin e Koncept Dokumentit pas analizave dhe konsultave të zhvilluara më grupet e interesit, në takime te ndara, takime konsultative dhe informative, ka ardhë në përfundim se Opsioni i Dytë, është më i përshtatshëm në këtë fazë kohore, për të ofruar zgjidhje për problemet dhe shqetësimet e paraqitura.

Opsioni 1 - nuk priten përfitime, as në të drejta e as në zbatimin e legjislacionit në fuqi. Përkundrazi, vazhdimi i gjendjes së njëjtë do të rriste pakënaqësi tëk familjarët si dhe do të pamundësonte autoritetin zbatues të ligjit-KQPZH që të kryej me sukses detyrimet e veta ligjore. Vazhdimi me të njëjtën politikë ligjore do të thellonte pabarazinë dhe do të rëndonte gjendjen ekonomike-sociale dhe psiko-sociale të familjeve të personave të zhdukur.

Opsioni 2 - Plotësim ndryshimi i legjislacionit që trajton çështjen e personave të zhdukur, është opsion që në mënyrë efektive avancoon përkujdesin institucional për mbrojtjen e interesit me të mirë të personave të zhdukur dhe familjarit të tij, sikurse edhe përmirëson nivelin e zbatimit të ligjit dhe llogaridhënien institucionale. Ky opsion ndikon drejtpërdrejtë në mirëqenien e familjarëve të të zhdukurve, sikurse edhe eliminon pabarazinë e shprehur në legjislacionin aktual.

Ky opsion do të mundësojë:

- Hartimin e akteve nënligjore, të nevojshme për zbatim të ligjit;
- Kryimin dhe mirëmbajtjen e Listës Qendrore të Personave të Zhdukur;
- Pajisjen e familjarëve të PZH me dokumentacion adekuat;

- Fuqizimin e pjesëmarrjes së Shoqatave të Familjeve të të Zhdukurave dhe familjarëve në vendimmarrje dhe lulumin të fakti të personave të zhdukur;
- Përfitimn e mbështetjes adekuat shtetërore për anëtarët e familjeve të PZH;
- Rregullimin e artifikakteve dhe rrobave të PZH;
- Trajtimin e mbetjeve mortore NN në morgun e IML;
- Mbështetjen institucionale të shoqatave të familjarëve të PZH;
- Informimin dhe konsultimin e palëve të interesuara;
- Varrimin e mbetjeve mortore që nuk janë me interes mjekoligjor;
- Zgjidhjen ligjore të Statutit të PZH dhe të familjarëve të tyre;
- Rregullimin e lokacioneve/varrezave masive ku janë gjetur të zhdukurit;
- Efikasitet të shtuar të Njësisë Administrative të KOPZH dhe në përgjithësi strukturës institucionale ;

Grupi Punues ka vlerësuar se ky opsion është më real dhe në aspektin kohor.

Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, Persona të Zhdukur dhe Peticione ka rekomanduar avancim të legjisllacionit që trajton cështjen e Personave të Zhdukur. Kjo lërkësë është fuqizuar edhe me Rezoluten e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila kërkon angazhim më cilësor dhe hartim të politkave të efektshme për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur dhe mbrojtjen e interesit të familjeve të të zhdukurve.

Opsioni 3 - nuk do të ndikonte më shumë se sa opsioni i dytë, në realizimin e të drejtave të personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre apo në zbatim më të efektshëm të ligjit.

Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme

Figura 8: *Plani i zbatimit për Opsionin 2*

Qëllimi i	Statusi i personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre	
-----------	--	--

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Politikës											
Objektivi strategjik	Trajtimi i barabartë i familjeve të kategorive të dala nga lufta										
	Shifra e koston së pritur										
Statusi i Personave të Zhdukur dhe Familjeve të tyre pas gjetjes dhe identifikimit	Plotësim ndryshim Ligji Nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur;	Rregullimi ligjor i Statutit të Personave të Zhdukur dhe Familjarëve të tyre									
		Terminologjia person i "ZHDUKUR" apo i" PAGJETUR"					Institucioni /departamenti përgjegjës				
		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5					
		X					ZKM/ KQZKH		NUK KA		
		Përkufizimi dhe Statusi Statusi i Personit të Zhdukur, Familjarëve të të Zhdokurve pas gjetjes dhe identifikimit të tyre.									
		Përkrahja : pensionet dhe beneficionet tjera (harmonizimi i të drejtave për kategoritë e luftës)									
Plotësim ndryshimi i dispozitave ligjore - Ligji nr.04/L-054		Viti1	Viti2	Viti3	Viti4	Viti5	Institucioni /departamenti përgjegjës				
							MPMS	Kosto shitesë: 108,000.00 (njëqindetetë mijë) Euro			
		X	X	X	X						
		Sigurimi i Përkrahjes shtetërore (Zëvendësimi i termit 'pension', me termin 'përkrahje shtetërore'). Mundësia për lejimin, pastaj edhe të pensionit të dytë									

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

	Rritja e përkrahjes/ pensionit mujor në shumën e propozuar prej 250.00 (dyqindpesëdhjetë) Euro	x	x	x	x	x	x	MPMS	Kosto shtesë 336,000.00 (treqindetridhij etëgjashtë mijë) Euro
	E drejta e përkrahjes / pensionit për familjet e personave të zhdukur, nëse ruhet statusi i familjeve të personave të zhdukur, edhe pas identifikimit të mbejeve mortore	x	x	x	x	x	x	MPMS	Kosto shtesë 384,000.00 (treqindetetëdhjetëkater mijë) Euro
	E drejta e përkrahjes / pensionit për familjet e personave të zhdukur, pas identifikimit të mbejeve mortore të personave të zhdukur gjatë periudhës kohore që nuk mbulohet aktualisht me legjislacionin që garanton të drejtën e pensionit	x	x	x	x	x	x	MPMS	Kosto shtesë 300,000.00 (treqindmijë) Euro
	Harmonizimi i të drejtave dhe beneficioneve të familjeve të personave të zhdukur me	x	x					ZKM MPMS MSH MASHT	Kosto administrative

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONATE ZHDUKUR

		kategoritë e tjera të luftës							
		Krijimi i Memories Kolektive							
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
Ruajtja e memories kolektive	Rregullimin e artfakteve dhe rrobave të personave të zhdukur;	Konservimi dhe barja për në lokacionin e ri, me qëllim të evitimit të dëmtimit të mëtejshëm	x	x				KQPZH (ZKM, MD, IML); MAP;	Nuk ka kosto financiare
	Përgatitja e artfakteve dhe rrobave të personave të zhdukur për Muze	Trajtimi profesional dhe klasifikimi me qëllim të bartjes në Muze / Kompleksin Memorial		x				KQPZH ; MKRS ; KUVENDI (AKMKMK)	10,000.00 (dhjetë mijë) Euro , brenda vitit
	Shënjimi i lokacioneve të vendvarrezave	Shënjimi i lokacioneve ku janë gjetur / zhvarrosur mbetjet mortore ; Plakat përkujtimore dhe memorialet;		x	x	x		KQPZH ; Komunitat ;	10,000.00 (dhjetë mijë) Euro , brenda vitit
	Rivartimi i mbetjeve mortore NN	Rregullimi i lokacionit dhe rivartimi i mbetjeve mortore , që janë jashtë interesit forenzik	x	x	x			KQPZH (ZKM, MD, IML) ; Komuna e Prishtinë;	10,000.00 (dhjetë mijë) Euro

Përkrahja e shogatave dhe struktura institucionale	Përfshirja e aktive në proces dhe përkrahja e shogatave	Përkrahje e vazhdueshme për funksionimin e shogatave , intensifikimi i komunikimit dhe rritja e transparencës	x	x	x	x	x	x	ZKM-KQPZH	100,000.00 (njëqindmijë) Euro, kosto shtesë, brenda vitit si dhe 200,000.00 aktualisht, dmth gjithsejtë 300,000.00 (treqindmijë) Euro
	Ri-strukturimi institucional	përfshirja aktive e shogatave të famijëve në proces; Efikasitet të shtuar të Njësise së KQPZH-së ;	x	x	x	x	x	x	ZKM - KQPZH	

Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet

Figura 9: Krahësimi i opsioneve

Mjeti i krahasimit:				
Opsioni 1: Asnjë ndryshim		Opsioni 2: Plotësim Ndryshim i Legjislacionit		Opsioni 3:

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Ndikimet relevante pozitive	Nuk do të kishte asnjë ndikim pozitiv			Zgjidhja e Statutit të Personit të Zhdukur dhe Familjeve të tyre			Adreson dhe u jep zgjidhje pjesërisht problemeve të paraqitura deri më tash.		
				Eliminimi i pabarazisë mes familjeve përfutuese të kategorive të dala nga lufta					
				Do të adresoj dhe zgjidhë problemet e paraqitura me legjislacionin aktual					
				Zbatim më efikas të legjislacionit					
Ndikimet relevante negative	Do të vështirësoje me problemet ekzistuese dhe thellimin e pakënaqësive të grupeve të interesit.			Nuk do të ketë asnjë ndikim negativ			Nuk adreson mjaftueshëm, kërkesat e familjeve dhe përprjekjet e institucioneve kompetente që familjet të kenë një trajtim më të mirë ligjor e institucional		
Kostot relevante				Do të krijojë kosto shtesë, e cila duhet të planifikohet					
Vlerësimi i ndikimit të pritshëm buxhetor	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3
				1,128,000.00	1,128,000.00	1,128,000.00			
Përfundimi	Nuk rekomandohet			Opsioni i rekomanduar			Nuk rekomandohet		

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Figura 10: Plani i zbatimit të opsionit të preferuar

Veprimi		Afati kohor
1.	Plotësim ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-023	K3 2019
2.	Amandamenti i dispozitave të Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmoreve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre (qëshqjet që ndërliohen me pension ; dhe benficionet tjera me qëllim të trajtimit të barabartë mes kategorive të luftës)	K3 2019
3.	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore	K4 2019

Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

Plani i veprimit për zbatimin e opsionit të rekomanduar të këtij Koncept Dokumenti do të reflektohet në Planin e Punës së Zyrës së Kryeministrit dhe zbatimi i saj do të monitorohet nga zyra e Kryeministrit.

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A priet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i prishëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës ¹	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		X			

¹ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Bëria e biznesit	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?	X				
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		X			
	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		X			
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		X			
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		X			
Ngarkesa administrative	A do të detyrohen bizneset të mbyllën?		X			
	A do të krijohen biznese të reja?		X			
	A do të detyrohen bizneset t'i përbushin detyrimet e dhënjes së informatave të reja?		X			
	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënjes së informatave për bizneset?		X			
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		X			
Tregtia	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?		X			
	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?		X			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?		X			
Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?		X			

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

	A pritët që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		X			
	A do të rriten investimet nga diaspora?		X			
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		X			
	A do të rriten investimet e huaja direkte?		X			
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		X			
Konkurruesh mëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?		X			
	A do të ulët çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?		X			
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?		X			
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		X			
	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?		X			
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		X			
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		X			
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		X			
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		X			

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?		X			
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		X			
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?		X			
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		X			

Shtoja 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?	Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur		Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
			Po	Jo		
Vendet e punës ²	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?			X		
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?			X		
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?			X		
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?			X		
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?			X		

² Kur ndikkon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Ndikimet shqërore rajonale	A janë ndikimet shqërore të përgendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		X				
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?		X				
	A parashihen apo shtuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?		X				
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		X				
	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?	X					
Përfshirja sociale	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?	X					
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?						
	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skenave të mbrojtjes sociale?						
	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		X				
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?		X				
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?		X				
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?		X				
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?		X				
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?		X				

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		X				
Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?	X					
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		X				
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?	X					
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?	X					
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?		X				
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?		X				
	A do të informohet në mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?	X					
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partië politike?		X				
	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?	X					
Shëndeti dhe siguria publike ³	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?		X				
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?		X				

³ Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Krimi dhe siguria	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?		X				
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?		X				
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?		X				
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?		X				
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		X				
	A ka grupe të veçanta që përballen me treziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si moshë, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?						
	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?		X				
	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?		X				
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?		X				

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?		X		
	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?		X		

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)?		X			
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?		X			
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?					
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?		X			
	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?		X			
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		X			
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		X			

	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?				
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?	X			
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndoqjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?	X			
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?	X			
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?	X			
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?	X			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzimin bujqësor apo urban)?	X			
Mbeturinat dhe ricklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të gjeneruara?	X			
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?	X			
	A do të ketë ndikim në mundësitë për ricklimin e mbeturinave?	X			
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut,	X			

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

	hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?						
	A ndikun opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, gymyri etj.)?		X				
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?		X				
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?		X				
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		X				
	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?		X				
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?		X				
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		X				
	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		X				
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		X				
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		X				

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore X

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Dinjteti	A ndikon opsioni në dinjtetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?	X				
	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?		X			
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?		X			
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?		X			
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?	X				
Liria	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fese?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?	X				

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?	X						
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?		X					
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?	X						
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		X					
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?	X						
	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?		X					
Trajtimi i barabartë ⁴	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	X						
	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose fetër, moshe ose orientimi seksual)?		X					
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?		X					
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?		X					

⁴ Barazia gjinore trajtohet në Vlerësimin e Ndikimit Gjinor

KONCEPT DOKUMENT PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuara?		X				
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?		X				
	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?		X				
	A ndikohet qasja në drejtësi?		X				



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministrastva za Financije - Ministry of Finance
Departamenti i Buxhetit-Budzet Department-Budget Department
Formulari i Vlerësimit të Ndihmës Buxhetor

Organi propozues :	Zyra E Kryeministrit								
Titulli i Nismës së Re:	Koncept dokumenti per persona te zhdukur								
Dorëzuar nga:	Zyra e Kryeministrit								
Qëllimi i Nismës së re:	Rregullimi i statusit të personave të zhdukur dhe familjeve të tyre								
Objektivat e Nismës së re:									
Treguesit e Efikasitetit të Produkteve:									
Produkti	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3					
	Sasia	Njësia matëse	Kostoja për njësi	Sasia	Njësia matëse	Kostoja për njësi	Sasia	Njësia matëse	Kostoja për njësi
familje perituese	700	rr	1,544	700	rr	1,544	700	rr	1,544
Vlerësimet e Hershme për Organin Propozues/Programin sipas KAB-it aktual									
	Viti 0	Viti 1	Viti 2						
Paga dhe Mëditje	1,020,667.00	1,025,770.34	1,030,899.19						
Mallra dhe Shërbime	957,989.00	957,989.00	902,075.00						
Komunal	24,592.00	24,592.00	24,592.00						
Subvencione dhe transfere	275,000.00	609,875.00	275,000.00						
Shpenzime Kapitale	-	-	-						
Gjithsej	2,278,248.00	2,618,226.34	2,232,566.19						

	Viti 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Kostoja totale	-	26,400.00	26,532.00	26,664.66
Paga dhe Mëditje	-	10,000.00	10,000.00	10,000.00
Mallra dhe Shërbime	-	-	-	-
Komunal	-	1,428,000.00	1,428,000.00	1,428,000.00
Subvencione dhe Transfere	-	-	-	-
Kapitale	-	1,464,400.00	1,464,532.00	1,464,664.66
Gjithsej	-	1,464,400.00	1,464,532.00	1,464,664.66

Burimet e Propozuara të Financimit	-	1,128,000.00	1,128,000.00	1,128,000.00
Buxhet Shtesë nga KAB i Ardshshëm	-	-	-	-
Numri i Punetoreve	-	-	-	-
Paga dhe mëditje	-	-	-	-
Mallra dhe Shërbime	-	-	-	-
Komunal	-	1,128,000.00	1,128,000.00	1,128,000.00
Subvencione dhe Transfere	-	-	-	-
Shpenzime Kapitale	-	-	-	-
Paranë të Zhvillimit (donatorët)	-	-	-	-
KAB Ekzistues	-	336,400.00	336,532.00	336,665.00
Paga dhe mëditje	-	26,400.00	26,532.00	26,665.00
Mallra dhe Shërbime	-	10,000.00	10,000.00	10,000.00
Komunal	-	-	-	-
Subvencione dhe Transfere	-	300,000.00	300,000.00	300,000.00
Shpenzime Kapitale	-	-	-	-
Financim nga Huamarrja	-	-	-	-
Tjetër (p.sh. PPP)	-	-	-	-
Gjithsej	-	1,464,400.00	1,464,532.00	1,464,665.00

Pjesa pa financim të paraparë	-	-	-	-
-------------------------------	---	---	---	---

Komente shtesë për financim

Koncepti dokumenti për persona të zhdukur, opcionit I rekomanduar I cili parasheh plotësimin e legjislacionit ekzistues (Ligji nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur dhe Ligji Nr. 04/L-054 Për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve Invalidëve Veteranëve Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Viktimave Civile dhe Familjet e Tyre) I cili rregullon qeshtjen e personave të zhdukur. Me plotësim ndryshimin e legjislacionit ekzistues parashihet që familjet e personave të zhdukur të kenë trajtim me të mirë ligjor dhe institucional që parashihet rritja e përfitimeve për familjet e personave të zhdukur. Kjo rritje krijon kosto shtesë buxhetore në shumë prej 3,384,000 € për periudhën 2020-2022. Kjo kosto shtesë e shprehur është si vijon: 1. 350 familje (përfitues) nga rritja eventuale e 'përkrahjes shtetërore (pensionit të deritanishëm). Diferenca financiare e përkrahjes do të jetë rreth 80.00 (tetëdhjetë Euro) në muaj. 2. Rreth 100 familje të personave të zhdukur, qytetar të Kosovës, të identifikuar pas Qershorit 1999 (sipas datave të parapara në Ligjin nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur). 'Përkrahjes shtetërore' për këtë kategori do të jetë ekuivalente me planifikimet për rritje, përkatësisht 250.00 (dyqindpesëdhjetë) Euro në muaj. 3. Si dhe rreth 400 familjeve të personave të zhdukur, të identifikuar vite më parë. Përkrahje shtetërore për këto familje do të realizohen nëse me plotësim-ndryshimin e Ligjit sanksionohet edhe 'ruajtja e statusit të familjes si familje e personave të zhdukur, edhe pas identifikimit të personit të zhdukur'. Në fakt këto familje gëzojnë të drejtën e pensionit si familje të viktimave të luftës dhe në

Më:

Zyrtari Kryesor Financiar

Zyrtari Kryesor Administrativ

Ministri/Kreu i Organizatës

Heshmësi

Heshmësi

Heshmësi